



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/ 16 dhe 83/18), si dhe nenit 65-d, paragrafit 1 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë

1. Në titullin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17) dhe në tërë tekstin e Vendimit, përveç pikës 17, fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut".

2. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. Në bazë të nevojës së konstatuar për futjen, rritjen, zvogëlimin ose lirimin e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit nga pikat 9 dhe 10 të këtij vendimi, Këshilli i Bankës Popullore merr vendim për futjen, rritjen, zvogëlimin ose lirimin e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, në të cilën shënohen të paktën:

- shuma e shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit dhe
- data kur bankat janë të detyruara të zbatojnë shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike, pra kur pushon detyrimi për ruajtjen e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit, duke marrë parasysh përcaktimet e paragrafit 2 të kësaj pike.

Në rast të zvogëlimit të shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në rast të lirimit të kërkesës për shtresë mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zvogëlimi, përkatësisht lirimi hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të vendimit për zvogëlimin, përkatësisht lirimin e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Banka Popullore boton futjen, rritjen, zvogëlimin ose lirimin e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit në faqen e vete të internetit, në përputhje me ligjin. Në rastet kur gjatë futjes ose rritjes së shkallës së shtresës mbrojtëse kundërciklike të

kapitalit, përcaktohet data e zbatimit, e cila është më e shkurtër se 12 muaj, detyrimisht botohen edhe arsyet e përcaktimit të datës më të shkurtër të zbatimit."

3. Në pikën 14, paragrafi 1, në fjalinë e dytë, fjalët: "Banka Popullore botoi ose nuk botoi", zëvendësohen me fjalët: "Këshilli i Bankës mori mori ose nuk mori vendim".

Paragrafi 3, nënparagrafi 1 ndryshohet si më poshtë:

"– SZ është shkalla e shtresës mbrojtëse kundërciklike për ekspozimet ndaj vendit Z, për të cilën ka marrë vendim Këshilli i Bankës Popullore. Nëse Këshilli i Bankës Popullore nuk ka marrë vendim për shkallën e shtresës mbrojtëse kundërciklike të kapitalit për ekspozimet ndaj vendit të caktuar, SZ është e barabartë me 0%;

4. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V. nr. 02-15/VI-7/2021
28 prill 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska